REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HAS
DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE
EMERGJENCA CIVILE

Nr. 3563 Prot.

Krumë, me 06 /10 /2025

MIRATOHET
KRYETARI
MIFTAR DAUTI

PLAN-VEPRIMI

PËR PËRBALLIMIN E SITUATAVE EMERGJENTE QË MUND TË KRIJOHEN GJATË PERIUDHËS VJESHTË - DIMËR NË BASHKINË HAS

Për periudhen Nëntor 2025- Mars 2026.

Në zbatim të Ligjit nr. 45, datë 18.07.2019 "Për Mbrojtjen Civile", Ligjit Nr.139/2015", Për Vetëqeverisjen Vendore" Planit të Emergjencave Civile të Bashkisë Has, hartohet ky Plan-Veprimi.

Objektivi: Përgjigjia e strukturave përgjegjëse për përballimin e situatave emërgjente të krijuara nga kushtet e motit.

I. Informimi dhe monitorimi i situatës:

Si rezultat i periudhes të stinës së dimrit, territori i Bashkisë Has mund të shoqërohet me reshje intensive të deborës, erërave të fuqishme pasojë e së cilës mund të kemi bllokimin e territoreve të Njesive Vendore te Bashkisë, veshtirësimin e qarkullimit në akset rrugore nacionale e gati e pamundur levizja e mjeteve në akset rrugore Rurale.

Mund të kemi shfaqjen e një sërë problemesh si në emergjenca shëndetësore, ushqimore të komunitetit deri në bazen ushqimore të blegtorisë.

Në Bashkinë e Hasit si pasojë e përkeqësimit të kushteve klimaterike mund të krijohën vështiresi të mëdha në jetën e komunitetit si në atë ekonomike, sociale, shëndetësore, qarkullimin e lëvizjes së mallrave, pasagjereve, etj.

Adresa: Sheshi "Deshmoret e Hasit", Pallati i Kultures "Pjeter Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,
Tel/Fax.: +355 214 22080, E-mail: info@bashkiahas.gov.al

Qëllimi: Marrja e masave për përballimin e situatave emergjente në angazhim të plotë me të gjithe aktoret, përgaditet ky Plan-Veprimi i cili bazohet në këto drejtime kryesore:

1. Marrja e plote e masave për shëndetin e popullatës.
2. Mbajtja e akseve rrugore që përshkojnë Bashkinë Has.
3. Dhënia e ndihmave ushqimore për njerëzit më në nevojë dhe ndihma ushqimore për blegtorin atje ku është e mundur.
4. Shërbimet të tjera ndaj popullatës (Energji Elektrike dhe Uji i Pijeshëm).
5. Probleme te tjera organizative.

I.Marrja e plotë e masave për shëndetin e popullatës.

- Ngritja e grupit të punës në të gjitha strukturat shëndetësore me qëllim ndjekjen e gjithë situatës shëndetësore të popullatës.

Brenda dt. 20. 11. 2025.
Drejtoria e Shëndetit Publik.
Drejtoria e Shërbimit Spitalor.
Drejtoria e Sigurimeve Shëndetsore.
Drejtuesit e Qendrave Shëndetsore.

- Organizimi i sitemit të lajmërimit për rastet e emergjencave shëndetësore (për të cilat është e pamundur ndërhyrja nga strukturat shëndetsore të zones tone).

Njësite Administrative të Bashkisë.
Drejtoria e Shëndetit Publik.
Drejtoria e Shërbimit spitalore.
Komisioni i Emergjencave civile i bashkisë.
Brenda dt.30.11.2025.

Drejtuesit e Institucioneve të përfshira në këtë pike.

- Mbajtje e kontaktit në menyrë të vazhdushme me strukturat shëndetsore, (qendrat shëndetsore) me njësit administrative me qëllim marrjen e informacionit ditor, mbi gjendjen shëndetsore të popullatës.

Cdo ditë.
Drejtoria e Shëndetit Publik.

- Informacion në institucionin e Bashkisë mbi situaten e gjendjën e medikamenteve shëndetsore në spitalin e rrethit dhe në të gjitha qëndrat shëndetsore si dhe bashkrëndimi i punës me farmacit e rrethit, për krijimin e rezervave dimërore në barnat mjekësore, marrja e masave për plotesimin e nevojave.

Gjatë gjithë kohës.
Drejtoria e Shëndetit Publik.
Drejtoria e shërbimit spitalore.

- Mbajtja në gadishmeri e urgjencave spitalore me grupe mjekësh e krijimi i 34 shtretërve rezervë për situatat emergjente shëndetësore që mund te krijohen.

Adresa: Sheshi "Deshmoret e Hasit", Pallati i Kultures "Pjeter Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,
Tel/Fax.: +355 214 22080, E-mail: info@bashkiahas.gov.al

Gjatë gjithë kohës.
Drejtoria e shërbimit spitalore.

- Ne rastet e emergjencave të raportohet cdo dite me shkrim ora **08:30 e 16:00** për problematiken ditore tek grupi i punës Komisionit Emergjencave civile.

Drejtoritë e Shëndetit Publik.
Drejtoria e shërbimit spitalor.

II.Mbajtja e akseve rrugore që përshkojnë Bashkinë Has.

- Drejtoria e Sherbimeve pranë Bashkise të marrin masa duke hartuar marrëveshje me subjekte private dhe të planizoje punën për mbajtjen në gadishmeri të rrugëve që kanë në inventarin e tyre dhe zhbllokimin e tyre në rast emergjencash. Ndërsa me mjetet e sajë të marrë masa që rrugët kryesore të lagjeve gjatë gjithë periudhes së dimrit të mos bllokohen nga bora ose nga ndonje faktor tjetër.

Brenda dt. 27.11.2025.
Drejtoria Shërbimeve.
Njësit Administrative.

- Subjektet private "ARBOTEC", dhe "GRIALD" sipas kontratave që kanë me autoritetin kombëtar të mirëmbajtjes së rrugëve të hartojnë grafikun e shpërndarjes së mjeteve për pastrimin e akseve rrugore nga dëbora apo nga prurje të ndryshme nga reshjet e shiut të dëbores ose ortiqet duke përcaktuar konkretisht aksin përkatës, mjetin me personin përgjegjës dhe piken e kontaktit.

Brenda dt. 26.11.2025.
"ARBOTEC" SH.P.K.
"GRIALD" SH.P.K.
Policia Rrugore.

- Të realizohet një takim pune me përfaqesuesit e subjekteve sipërmarrëse, të verifikohen mjetet që janë në terren e të kontaktohet me pronaret e tyre te cilat mund te merren kundrejt pagesës për kryrjen e punimeve në akset rrugore të ndryshme për heqjen e borës.

Brenda dates 30. 11.2025.
Drejtoria e Shërbimeve.
Adm. e Njesive Administrative.

- Të raportohet për punën e berë në hapjen e akseve rrugore sipas formularit që do të vihet në dispozicion të Komisionit të Emergjencave Civile të Bashkisë dhe Grupi i Punës.

Cdo 2 (dy) orë.
Drejtoria e Mbrojtjes Civile.
Njësit.Administrative.

Adresa: Sheshi "Deshmoret e Hasit", Pallati i Kultures "Pjeter Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,
Tel/Fax.: +355 214 22080, E-mail: info@bashkiahas.gov.al

- Të përcaktohen dhë të propozohen prioritetet në Komisionin e Emergjencave Civile, ku do të punohet në akset rrugore.

Cdo ditë në mbledhjen e fundit.
Drejtoria e Mbrojtjes Civile.

"Arbotec", dhe "Griald" Sh.p.k.

- Tu jepen udhëzime Administratorëve të Njësive Administrative për veprimtari të përbashkëta në komunitet, për lidhjen me rrugë të shtëpive, lagjeve e fshatrave.

Gjatë situatës emergjente.
Grupi i punës.

III.Dhënie e ndihmës ushqimore për popullatën në nevojë, si dhe bazen ushqimore për blegtorinë.

- Zyra e Bujqësise dhe Autoritetit Kombëtare i Ushqimit të monitorojnë gjatë gjithë kohës gjendjën e ushqimeve bazë për popullatën, shqetësimet dhe problemet të cilat mund të ketë gjatë kësaj emergjence.

Gjatë situatës Emergjente.
Zyra e Bujqësisë.
Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

- Zyra e bujqesisë dhe punonjësit e autoritetit kombëtar të ushqimit të propozojnë komisionin e ECN/P për prioritetet e ndërhyrjes dhe mënyrat në drejtim të problematikes që mund të krijohen në furnizimin me ushqime të popullatës dhe blegtorisë.

Gjatë situatës së Emergjencës.
Zyra e Bujqësisë.
Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

- Të japin informacion në institucionin e N/prefektit, Bashkinë Has mbi rezervat ushqimore që janë nga subjektet private në Rrethin tonë, numrin e furrave të bukës, të ndara sa punojnë me dru dhe sa me energji, mullit e blojes të ndarë sa me ujë e sa me energji, duke nxjerrë kapacitetet e tyre prodhuese.

Brenda datës 20.11.2025.
Zyra e Bujqësise.
Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

- Të inspektohet gjendja e ushqimeve bazë në pikat e shitjes me shumicë dhe pakice duke bërë ndërhyrje ligjore me rastin e shkeljeve së standarteve.

Gjatë situatës.
Zyra e Bujqësisë.
Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

- Të mbahen kontakte të vazhdueshme me drejtuesit e organeve vendore për marrjen e informacionit mbi gjendjën e ushqimeve për popullatën dhe problematikat që kanë për bazën ushqimore të blegtorisë. Gjithashtu tu jepen udhëzime Përgjegjësit të njesive vendore, për sensibilizimin e veprimtarive të përbashkëta në komunitet, me qëllim dhënien e ndihmës reciproke ndërkomunitare në ushqimin e popullatës si dhe bazës ushqimore të blegtorisë.

Gjatë situates.
Zyra e Bujqësisë.

- Nga Sektori i Bordit të Kullimit. pranë Bashkisë të jepet informacion KECN/P mbi gjendjen e digave të ujëmbledhësve dhe mekanizmit të shkarkimit të ujrave.
- Mirembajtja e sistemit të kullimit dhe veprat mbrojtëse si dhe të përrenjëve për të parandaluar përmbytjet, të ndiqet me prioritet gjendja e tyre.

Gjatë Situatës.
Bordi Kullimit.

IV.<u>Shërbimet e tjera të popullatës</u>

- Njesia O.SH.E.E të ndjek në vijimësi furnizimin e popullatës me energji elektrike e të marrë masat e plota për ndërhyrjet në defektet që mund të dalin si dhe krijimin e reservës logjistike për situaten emergjentë.

Gjate situatës.
Njësia e O.SH.E.E.

- Ndërmarrja e ujësjellës kanalizimeve të mbajë në gadishmëri linjat e furnizimit me ujë të pijshëm të popullatës duke monitoruar dhe ndërhyrë në defektet që mund të krijohen nga temperaturat e ulëta, apo demtimet e tubacioneve nga reshjet e shiut.

Gjatë situatës.
"Ujësjellës kanalizime"Sh.a.

- Nga strukturat arsimore në bashkëpunim me organet vendore të ndiqen me përparsi gjendja e ambjenteve shkollore, mundësitë e levizjes së nxënësve e të vendoset sipas akteve ligjore për ecurinë e procesit mësimor sipas situatave të emergjencës.

Gjatë situatës.
Zyra Arsimore Has.

- Nga Njësit Administrative të mbahen nën vëzhgim terrenet të cilat janë nën efektin e fenomeneve të rrëshqitjes masive, orteqeve dhe fenomeneve te tjera që rrezikojnë jetën e komunitetit.
  Të planizohet marrja e masave për evakuimin e popullatës në rastin e situatave emergjente dhe kthimin në normalitetit.

Të dërgohen pranë Bashkisë listat e familjeve më në nevoje ku të jenë këto të dhëna: emri, atësia, mbiemri i kryefamiljarit, numri i frymëve dhe adresa e plotë.

Njësitë administrative.
Nga data 15.11.2025 e në vazhdim.

V.Strukturat Operacionale

a) Komisariati i Policisë Has:

- Të mbajë në gadishmëri në dispozicion të Komisionit të Emergjencave Civile dy mjete të kalushmërisë së lartë e një efektiv prej 12 vetash për ndërhyrje operacionale.
- Të rrisë më tej punën për mbarëvajtjen e rendit e qetësisë publike e të luftës kundër krimit, në rastet e ngjarjeve emergjente si në aksidente rrugore, orteqe, etj. Të izolojë e të marrë menjëherë nën kontroll rajonin ku zhvillohet ngjarja.

b) Policia Kufitare dhe Emigracionit:

- Të mbajë në gadishmëri në dispozicion të Komisionit të Emergjencave Civile 1 mjet te kalushmërisë së lartë e një efektiv prej 3 vetash për ndërhyrje operacionale.

c) Njësia e Qarkullimit rrugore:

Të mbajë nën monitorim me shërbim 24 orësh aksin Nacional.
Të mbajë një grup prej 4 vetash për ndërhyrje në raste emergjencash.

d) Policia e PMNZH-se
- Të jetë e gatshme me nje grup prej 4 vetash per operacionet e kërkim shpëtimit.

VI.Probleme organizative

Nga Komisioni i Mbrojtjes Civile të realizohen këto detyra:
Përpilimi i urdhërave për funksionimin e veprimtarive në zbatim të detyrave të vëna nga komisioni i Emergjencave Civile të prefekturës.

Të përgatitet planizimi për shpërndarjen e ndihmave si, kerkesat, gjendja e mallrave ne magazinë, urdhërat përkatës për magazinimin, ngarkim, shkarkim, dorëzim të mallrave.

Të mbahen kontakte të vazhdueshme me KECQ (Drejtorine e Pergjithshme të Emergjencave Civile, Qendrën Operacionale), ndërmjet dhënies së informacionëve si me shkrim ashtu dhe telefonike.

Drejtoresha e Mbrojtjes Civile

Arberie RADA

Përgjegjësi i Emergjencave Civile

Fatos AHMATI

Adresa: Shesh "Deshmoret e Hasit", Pallati i Kultures "Pjeter Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,
Tel/Fax.: +355 214 22080, E-mail: info@bashkiahas.gov.al